



Datë: 09.01.2026
Numër Protokolli: 83/2026

A.nr.1900/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare; Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Hava Fekaj, Zyrtare e Lartë për Inspektim Administrativ si procesmbajtëse, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1900/2025 të datës 12.11.2025 të parashtruar nga ankuesi A.Ç, kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*Shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 6 paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.01.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1900/2025 të datës 12.11.2025 të parashtruar nga ankuesi A.Ç ashtu që, detyrohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi të rishqyrtoj kërkesën e datës 29.08.2025, të parashtruar nga ankuesi, A.Ç dhe të nxjerr akt administrativ në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, A.Ç (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 12.11.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Organit të Punësimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, lidhur me pretendimin ankimor për uljen e pagës së tij.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 01.12.2025, ndërsa kjo e fundit më datë 04.12.2025 ka përcjell shkresat e lëndës lidhur me çështjen përkatëse ankimore.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, dhe se i njëjti sipas Akt emërimit me numër protokolli 5541 të datës 22.10.2024, mbanë pozitës e punës “Zyrtar i Lartë për Emergjencë” në Departamentin Qendra për Menaxhimin e Krizave, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa sipas Vendimit me nr. Ref. 53, të datës 05.02.2025, te Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme që Z. A.Ç, me gradën diplomatike, *Sekretari i Dytë*, caktohet të shërbej në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Zagreb, Republikën e Kroacisë, me mandat katër (4) vjeçar nga data 1 prill 2025.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesi më datë 29.08.2025 ka parashtruar Kërkesë në Njësinë e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, lidhur me pretendimin ankimor për uljen e pagës së tij.

Sipas shkresave të lëndës, Kolegji ka vërejtur se ankuesi kishte paraqitur ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil A.nr.1207/2025 e datës 24.06.2025, për shkak të uljes në pagë. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka marrë Vendim me të cilin ankesa e ankuesit Hedhet poshtë si e pa lejuar, me arsyetimin se ankuesi nuk i është drejtuar paraprakisht me kërkesë Organit të Punësimit gjegjësisht Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, veprim ky i domosdoshëm për iniciimin e procedurës sipas dispozitave të ligjit përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesi më datë 29.08.2025 nëpërmjet emaili ka parashtruar Kërkesë në Njësinë e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, lidhur me pretendimin ankimor për uljen e pagës së tij.

Më datë 12.11.2025, ankuesi, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Organit të Punësimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, lidhur me pretendimin ankimor për shkak të mos shqyrtimit të ankesës, të cilën ia ka dërguar Njesisë e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, lidhur me pretendimin ankimor për uljen e pagës së tij.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me rregullat e veprimeve procedurale të një organi publik, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (*tutje referuar: LPPA*), përkatësisht nenit 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: 2. *Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative*, si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: 1. *Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative*, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, në raport me kërkesën e datës, dhe kërkesën e datës 29.08.2025, të parashtruar nga ankuesi ngase sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e

njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, është dashur që të nxjerr akt administrativ në kuptim të vendosjes dhe të njoftoj palën për aktin e tillë, brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98 paragrafi 2 apo afatit të vazhduar sipas nenit 99 paragrafi 1 të LPPA-së.

Kështu që thënë si me sipër e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar ankesën A.nr.1900/2025 të datës 12.11.2025, në kuptim të shkeljeve procedurale, dhe si rrjedhojë detyroj Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që në respektim të dispozitave procedurale të rishqyrtoj shqyrtoj kërkesën e ankuesit të parashtruar më datë kërkesat e datës 29.08.2025, dhe të nxjerr akt administrativ në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshillë Juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1900/2025

Hava FEKAJ

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, A.Ç;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.